

BARDHYL DEMIRAJ

KERKESË E KOHËS – NXJERRJA NË PAH E ORIGJINALITETIT TË GJUHËS SONË

Revista «Gjuha jonë» sapo hyri në dhjetëvjeçarin e dytë të jetës së saj. Kohë deri diku e shkurtër ajo që la pas, por që mjaftoi pér ta shndërruar atë në vatrën shkencore më popullore të gjuhës shqipe. Mësuesi i gjuhës dhe akademiku, studenti dhe specialisti kuvendojnë pranë e pranë e lirshëm pér atë dëshirë fisnik e mbarëshqërore, siç është lëvrimi i një shqipeje letrare të njësuar, të pastër e të pasuruar, përvetësimi i një kulture të lartë gjuhësore nga të gjithë bartësit e saj.

Nga viti në vit, nga numri në numër revista e ka zgjeruar problematikën, ka ngërthyer drejtimet themelore të studimit të gjuhës së sotme letrare dhe të kulturës në përgjithësi. Nëpërfaqet e saj sendërtohet një veprim i vetëdijshëm i shoqërisë ndaj zhvillimit cilësor të komunikimit masiv: pastrimit dhe pasurimit të gjithhershëm të gjuhës shqipe, kristalizimit dhe zbatimit të normës letrare në drejtshkrim dhe në drejtshqiptim, përvijimit të stileve të ndryshme funksionale, shqipërimit dhe njësimit të terminologjisë tekniko-shkencore, përdorimit të drejtë të mjeteve gjuhësore në fusha të ndryshme të veprimitarisë shoqërore dhe probleme të tjera të kulturës së gjuhës.

Rrethanat e reja të zhvillimeve shoqërore-ekonomike që po përjeton shoqëria jonë, përfshirja e saj gjerësish në proceset e zhvillimit e të bashkëpunimit evropian, hapin hulli të reja në studimet pér kulturën e gjuhës në përgjithësi. Ndër drejtimet e ndryshme që ka ndjekur deri sot procesi shkencor, fiton përparësi si një kërkësë e kohës ndërgjegjësimi ndaj origjinalitetit të gjuhës dhe të kulturës sonë, theksimi i atyre tipareve që kushtëzojnë karakterin e tyre të veçantë, tërësisht të dallueshëm nga gjuhët dhe kulturat e tjera të këtij kontinenti.

Të gjitha nënsistemet e gjuhës, që nga leksiku me fondin e tij themelor, gramatika, sidomos gjedhet tipike sintaksore e deri te fjalëformimi do të përbën objekt hulumtues në këtë aksion gjithëkombëtar. Përkushtim më të madh kërkojnë marrëdhënet historike e parahistorike që ka vendosur shqipja në rrjedhë të shekujve me gjuhët fqinjë, raporti element i trashëguar: risi: huazim në të gjitha nënsistemet gjuhësore etj. Studimin më të efektshëm të këtyre fushave, që mund e duhet të trajtohen edhe në faqet e kësaj reviste, do ta mundësonte përditësimi me disiplinat e reja të gjuhësisë së zbatuar si didaktika gjuhësore, teoria e përkthimit, sociolinguistica, psikolinguistica etj. Kjo do të kërkonte gjithashtu edhe njojen dhe zbatimin më të mirë të metodave që mbizo-tërojnë në gjuhësinë e sotme moderne si strukturalizmi dhe gjenereativizmi.